

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FOTOLAJM/ Ky është daja i Zengjine Caushit, akuzohet se përdhunoi 34-vjeçaren!
ADRESA	https://piranjat.al/politike/fotolajm-ky-eshte-daja-e-zengjine-caushit-akuzohet-se-perdhunoi-34-vjec-i104293
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 18:12:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 18:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7f6ca05b5003e5d59483f0d89f30123dd54584d25697cb051d209e2831beb6be
TEKSTI	a3daa384526ae949157c6ddcd765e3f03e4577a1ea3854a288993f85b0a11e3c
PAMJA	fdd19bd64f10f406cf941a87c23cc132147cf2ead4856c1a5dc0b05ed793aa8d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	be6a798f8750d271ef978f3eb5265fd81cbc27ec09b9ed7035da8cb43660d816
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcf62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/be6a798f8750d271ef978f3eb5265fd81cbc27ec09b9ed7035da8cb43660d816>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: **Saudite anulon dërgesat** për klientët evropianë, të... **rasti i dajës së Zegjine** "Pranisë Besnikes", kryeministri Caushit nore... **vendoset edhe për pagat e** ndryshime në përbërjen e... **shqiptare është e furnizuar** Etnia, ushtria shqiptare sot... **me lehtësira fiskale** Demokratike kërkon nga qeveria që të... **Demokratike**

POLITIKE

FOTOLAJM/ Ky është daja i Zegjine Caushit, akuzohet se përdhunoi 34-vjeçaren!

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 20:07



Deputetja e PS, Zegjine Caushi ka reaguar me një deklaratë publike në lidhje me përfshirjen e dajës së saj në një rast dhune e përdhunimi të pretenduar nga 34-vjeçarja Merita Gremaj dhe plagosjen e babait të kësaj të fundit. Ajo ka postuar një foto të dajës së saj me Gremaj, ku shfaqen të përfaqur, ndërsa ajo mban një tufë me lule në dorë.

Deputetja tregon njohjen me Gremajn, duke thënë se kjo e fundit bashkë me dajën e saj i kanë pohuar se kanë vendosur të martohen, pavarësisht se babai i 34-vjeçares kishte kundërshtime.

"Duke iu referuar ngjarjes së ndodhur në fshatin Suk 2 dhe të publikuar nga mediat më 14.09.2026 dhe 15.09.2026, dëshiroj të sqaroj opinionin publik lidhur me informacionet e dhëna deri tani.

Familja e nënës sime përbëhet nga 11 fëmijë: 9 motra dhe 2 vëllezër. Të gjithë kanë familjet, punët dhe jetët e tyre, ndaj natyrshëm nuk kemi kontakte të vazhdueshme dhe të pandërprera me njëri-tjetrin. Vëllain e nënës, Bledar Bakaj, së bashku me znj. Merita Gremaj, e kam takuar rastësisht pas një takimi që kisha në atë zonë, në fillim të muajit qershor. Kam kaluar pranë banesës dhe kam parë të afërm dhe fqinjë, rreth 10-15 veta, në oborrin e banesës. Madje, aty kam takuar edhe një kushërri, të cili Merita Gremaj e kishte njeriun e afërt nga fisi i të atit.

Sapo kam hyrë në oborr kam parë Meritën, e cila m'u prezantua si bashkëjetuesja e Bledarit. I urova padyshim për lidhjen e tyre, pasi atë gjë po bënin edhe fqinjët që ishin prezent dhe më pas, si unë, edhe kushëriri im iu drejtua: "E keni ndarë mendjen? Do martoheni?"

Merita Gremaj tha : "Po po, i kam marrë parasysh kushtet në të cilat Bledari jeton, edhe pse babai s'e ka me qejf..."

"Se mos na hapni probleme", iu drejtova pas fjalëve të saj, referuar pëlqimit të babait. Gjëja kaloi me të qeshura dhe urime nga njerëzit e pranishëm.

Kam ndenjur rreth 10 minuta dhe kam levizur për angazhimet e mia, të tjerët kanë vazhduar të qëndronin.

Pas disa ditësh, pashë edhe në rrjetet sociale, fotografi të tyre së bashku, të qeshur dhe me lule në duar.

Ky është i gjithë informacioni që kam pasur dhe kam në lidhje me marrëdhënien e tyre. Për këtë ngjarje jam informuar përmes mediave, njësoj si opinioni publik.

Dua ta them shumë qartë: dënoj me forcë çdo formë DHUNE, pavarësisht se nga KUSH është ushtruar.

Në të njëjtën kohë, mendoj se ky është një rast që duhet të trajtohet me seriozitet e kujdes edhe nga këndvështrimi psikologjik, për të dy personat, me qëllim gjetjen e zgjidhjes së duhur dhe parandalimin e çdo përsëritjeje të mëtejshme.

Për pjesën tjetër, organet ligjzbatuese duhet të bëjnë punën e tyre", shkruan Deputetja

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 15 Shtator 19:51

[Përgjimet e Ron Yeffet, Edison Lika thirrje SPAK: Hetoni Ramën! Çoni në Kuvend kërkesë për arrestin e Ballukut](#)

Në protestën e 108, protestuesi Edison Lika tha se pasi Erion Veliaj u mbajt në burg sot me vendim të Gjykatës së Lartë, radh...

POLITIKE 15 Shtator 19:38

Ron Yeffet në përgjimet e bujshme, Bushkolaj: 'Akses i pakufizuar' te milionat, pse nuk vepron SPAK?

Audiopërgjimet e publikuara së fundmi kanë ngritur pikëpyetje mbi rolin e Ron Yeffet dhe aksesin që ai pretendohet se kishte në &c...

POLITIKE 15 Shtator19:27

Daja i saj premtoi vend pune dhe abuzoi me ish-bashkëjetuesen, Zegjineja thyen heshtjen

Deputetja socialiste Zegjine Çausi ka bërë një reagim publik lidhur me ngjarjen e ndodhur dy ditë më parë në Roskove...

POLITIKE 15 Shtator19:25

Shqipëria proteston! Denoncimi i fortë i qytetarit: Jam me epilepsi dhe nuk marr kemp

Një nga qytetarët në protestën e 108 publikoi disa dokumente, ku tregohet se ishte me epilepsi. Ai u shpreh se është 64 vjeç...

POLITIKE 15 Shtator19:22

108 ditë rezistencë, qytetarët marshojnë drejt Kryeministrit: Arrestoni Ramën!

Ka nisur marshimi i qytetarëve nga sheshi Skënderbej, drejt Kryeministrit. Sot bëhen 108 ditë nga revolta kundër qeverisë. ...

POLITIKE 15 Shtator19:13

Seanca e 17 shtatorit, 5 ministra japin llogari në Kuvend; vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve

Pesë interpelanca me ministra të qeverisë, disa projektligje dhe ndryshime në përbërjen e komisioneve parlamentare pritet të ...

POLITIKE 15 Shtator19:10

"Unë s'kam frikë nga njeri! Ti më njeh mua", gjyqtari Gerd Hoxha i kthehet Manjës: Pagat do t'i jepni, nëse nuk doni të bëni atentat kushtetues

Një moment tjetër tensioni u pa sot gjatë seancës dëgjimore të gjyqtarëve në komisionin kuvendor të Ligjeve, mes gj...

POLITIKE 15 Shtator18:58

Këllici: Përmes Roni Yeffet, ushtria shqiptare është e furnizuar me teknologji dhe pajisje kineze

'Përmes kompanive të kontrolluara nga Roni Efeti, ushtria shqiptare sot furnizohet me pajisje, teknologji dhe lëndë të parë ...

POLITIKE 15 Shtator18:39

Meta u la në burg, Blushi: Proces farsë me kryeprokuror Ramën

Deputeti i Partisë së Lirisë Tedi Blushi, ka komentuar faktin që GJKKO e ka lënë në burg sot kreun e PL-së Ilir Metë...

POLITIKE 15 Shtator18:37

"Mbi Ballukun rëndojnë akuzat më të rënda për një zyrtar të lartë", Bardhi: Pse SPAK i jep kohë Ramës për manovra politike?

Kreu i Grupit Parlamentar të PD Gazment Bardhi ka vijuar reagimet e tij në kuadër të kërkesës drejtuar SPAK për arrestimin e ...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri' / Edi Rama sul...

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

BOTA 15 Shtator

Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...


Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada ieta e kryeprokurorit italian të antimafias Nicola Gratteri ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premtë | ? 20:45 | ???? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.